



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



PJESA B: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË¹, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI KOMUNAL NOVOBËRDË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

"AOME SH.P.K " (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Furnizim me dru për ngrohje për të gjitha institucionet e K.K.Novobërdë me numër identifikues: NB 654 2020 011 121

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porositë" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontratë publike kornizë, duhet që të dërgojë "porositë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorinë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **18.08.2020** dhe përfundon në datën **18.05.2021**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë të gjitha institucionet e K.K. Novobërdë ku ka porosi

¹⁶ Para nënshkrimit të kontratës "kjo Draft Kontratë Publike Kornizë " duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit të prokurimit

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP² (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar verdi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

NR. I ARTIKULLI	PERSHKRIMI	NJESIA	SASIA E PERAFER E VLERESUAR	CMIMI NJESI - €
1	Furnizim me dru për ngrohje	M HAPSINOR	750	40.00
2	PRERJA E DRVE PER STUF	M HAPSINOR	750	1.00

Vlera totale indikative e kontratës është **30.750.00** Euro. Devrivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [+ - 30%]

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kontrata Publike Kornizë;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- Urdhër blerja;
- [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër

Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye. 6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhë [Shqipe]

³ in në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Fatos Ahmeti
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	18.08.2020
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Haris Makolli
Pozita:	MANAGERE
Nënshkrimi:	
Data:	18.08.2020
Vula:	



¹⁸ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATËS

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligj i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Furnizuesi, në fund të kontratës, do të raportojë me shkrim, tek Komuna e Novobërdës lidhur me sasitë e druve të dorëzuara tek autoriteti Kontraktues.. Raporti duhet të paraqes: 1. sasinë e druve të dorëzuara gjatë periudhës së kontratës 2. Sasija e druve të prera për stufë gjatë periudhës së kontratës 3. datën e faturave; 4. datën e pagesave.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.2	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues
Siguria e ekzekutimit	8.1	Furnizuesi, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Komuna e Novobërdës një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% (dhjetë përqind) i vlerës së kontratës për një kohëzgjatje deri më 18.06.2021. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.
Periudha e ekzekutimit detyrave	12	Kurdo që ndonjëri nga Autoritetet Kontraktuese palë të kësaj kontrate dëshirojnë që të blejnë dru për ngrohje dhe prerjen e tyre sipas kësaj kontrate, duhet që të dërgojnë një "Flete Porosi" tek Furnizuesi.
Cilësia e furnizimeve	16.2	Për furnizimin me dru Autoritetet Kontraktuese përmes komisionit për pranim lëshon raportin e pranimi pasi që të jetë bërë furnizimi me dru, të shkarkohen drutë dhe të bëhet palimi në tok, të ketë fletë përcjelljen e lëshuar nga (Agjensioni pyjor i Kosovës) dhe pasi të nënshkruhet fletë dërgesa nga komisioni i autorizuar i Autoritetit Kontraktues malli do të konsiderohet si i pranuar.

Inspektimi dhe testimi	17.2	AK rezervojnë te drejtën që të inspektojnë kohe pas kohe produktet e dorëzuara përmes Menaxheri i Projektit ,komisioni për pranim teknik të cilet Do të emërohet me vendim nga kryetari i komunës
		Menaxheri i emëruar nga ana e kryetarit duhet të ketë parasysh që asnjë porosi nuk duhet të lejohet pa pasur zotimin e mjeteve.
Pagesat	18	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual. Nuk ka pagesa paraprake. Kërkesat për pagese do të bëhet për furnizim me dru dhe për prerje të sasisë së druve (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit të faturave. Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të çdo muaji, Furnizuesi duhet të dorëzojë tek AK faturë origjinale, Fletë përcjelljen e lëshuar nga Agjensioni Pyjor ,Fletë dërgesën e nënshkruar nga komisioni si dhe raportin e komisionit për pranim të masës drusore të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro.
Vonesa në pagesa	18.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që të ndërpresë furnizimet e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues përkatës
Dorëzimi	19.3	Furnizuesi duhet që gjatë furnizimit të bëjë furnizimin dhe prerjen e druve në bazë të kërkesave të institucioneve në M hapsinor e që është e barabartë sipas specifikacionit teknik pjesë e DT, Liferimi i matirialit : Është përgjegjësi e Furnizuesit për të siguruar që çdo kërkesë për furnizim me Lëndë djerse Dru është e ligjshme vetëm nëse është e autorizuar nga Autoriteteve Kontraktuese Dorëzimi i matirialit : Afati kohor për dorëzimin e Masës drusore në pikat e shpërndarjes së Autoritetit Kontraktues është 10 ditë pune nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Anulimi i porosisë së dorëzimit: Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për furnizim me dru me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para kohës së liferimit të porositur.
Vërfikimi i operimeve	20	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet kontraktues
Pranimi i përkohshëm	21	Për furnizim dru për ngrohje Autoritetet Kontraktuese nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm.
Obligimet e garancionit	22.1	Furnizuesi garanton që furnizimet janë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet e kërkuara në DT. Furnizuesi garanton që furnizimet janë të ligjshme , nuk kanë asnjë defekt sasior apo cilësor dhe se në rast të konstatimit të këtyre defekteve, Furnizuesi do të bëjë përpjekje maksimale për zëvendësimin e menjëhershëm të druve të liferuar.

		Ne rast te defekteve apo mosfunksionimit normal te pajisjeve te Autoritetit Kontraktues, te shkaktuara nga cilësia e dobët e furnizimeve, Furnizuesi zotohet te bëjë kompensimin total të dëmeve te shkaktuara nga cilësia jo adekuate e furnizimeve.
Shërbimet pas shitjes	23.1	N/A
Pranimi përfundimtar	25	N/A
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	26	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet Komunës se Novobërdës
Ndërprerja e Kontratës nga Furnizuesi	27	Autoriteti Kontraktues ne këtë nen i referohet autoritet kontraktues
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në Kosovë është përgjegjës për pajtim të tillë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, në pajtim me ligjin e Kosovës. ose a) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh te Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

PJESA II. LISTA E ÇMIMEVE

NR. 1 ARTIKULLI	PERSHKRIMI	NJESIA	SASIA EPERAFER EVLERESUAR	CMIMINJESI €	TOTALI €
1	Furnizim me Dru per ngrohje	METER HAPSINO	750	40,00	30.000,00
2	PRERJA E DRVE PER STUF	METER HAPSINO	750	1,00	750,00
TOTALI I PERGJITHËSHM ME TVSH					30.750 ⁰⁰

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"AOME" SH.P.K
EMRI DHEMBIEMRI I PERFAQESUESIT	NAFIJE MAKOLLI
NENSHKRIMI:	
DATA:	20.07.2020
VULA:	